



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 55, datë 24 .12. 2012

**PËR
“NJË NDRYSHIM NË NUMRIN E PUNONJËSVE TË POLICISË BASHKIAKE TË
BASHKISË SË TIRANËS”**

Në zbatim nenit 32, gërma “ç”, të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); ligjit nr.8224, datë 15.5.1997 për “Organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe komunës” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr.903, datë 12.12.2012 për “ Disa ndryshime në vendimin nr. 313, datë 01.07.2002 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të Policisë së Bashkisë dhe Komunës” (i ndryshuar) dhe vendimit të Këshillit Bashkiak nr.79, datë 01.11.2002 për “Caktimin e strukturës, numrit të punonjësve dhe shpenzimeve të Policisë Bashkiake të qytetit të Tiranës” (i ndryshuar me VKB nr.9, datë 24.02.2006 për “Një ndryshim në numrin e punonjësve të të Policisë Bashkiake të qytetit të Tiranës”; VKB nr.28, datë 30.04.2007 për “Një ndryshim në numrin e punonjësve të Policisë Bashkiake të qytetit të Tiranës” dhe VKB nr.25, datë 17.07.2008 për “Një ndryshim në numrin e punonjësve të Policisë Bashkiake të qytetit të Tiranës”), me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë një shtesë prej 50 punonjësish (10 inspektorë dhe 40 policë), në strukturën e Policisë Bashkiake të qytetit të Tiranës.
2. Në pikën 1 të vendimit të Këshillit Bashkiak nr.79, datë 01.11.2002 për “Caktimin e strukturës, numrit të punonjësve, dhe shpenzimeve të policisë së bashkisë dhe komunës” (i ndryshuar), ndryshon sipas strukturës së mëposhtme:

Kryeinspektor	1
Inspektorë	40
<u>Policë</u>	<u>259</u>
Gjithsej	300

3. Efektet financiare të pikës 1 të këtij vendimi, dhe sigurimet shoqërore do të përballohen nga buxheti e vitit 2013, për strukturën organizative të Bashkisë Tiranë.

4. Ngarkohet Policia Bashkiake, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Drejtoria e Financës, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI